

URDHËR
Nr. 65, datë 1.2.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 682, DATË 21.12 2020, “PËR NDALIMIN E LËVIZJES PËRMES RRUGËVE AJRORE ME BRITANINË E MADHE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 3, gjerat “a”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”; në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit; me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19; si edhe të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, 595,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 682, datë 21.12.2020, “Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Britaninë e Madhe”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në pikën 1 të urdhrin, togfjalëshi “deri në datën 1.2.2021” zëvendësohet me togfjalëshin “deri në një urdhër të dytë”.
2. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu